



Prishtinë: 19.05.2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_819\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1472\_03\_16**;
- Ankesa e KESCO- sh.a. me adresë Rr. Bill Klinton nr.5, 10000 e datës **27.04.2016**.

në seancën e mbajtur më datë 19 maj 2016, nxori këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së e ushtruar kundër vendimit të DMK-së për konsumatorin R. M. me shifër DPR- 90036958, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1472\_03\_16** i datës 31.03.2016.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 27.04.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga KESCO me të cilën është kundërshtuar vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: KESCO në ankesë ka theksuar se përkundër faktit se ne shifrën e konsumatorit ka pasur grumbullim të kilovatëve konsumatori nuk është ngarkuar më tepër se sa ajo çka i njëjti ka shpenzuar gjë për të cilën KESCO ka bërë korrigjimin financiar duke marr për bazë periudhën nga 11/2012 deri 10/2013. KESCO më tej ka theksuar se DMK/ZRRE në vendimin e saj kërkon që të hiqen kWh të cilët janë shpenzuar, regjistruar me njehsor dhe të faturuar vetëm njëherë dhe atë në kohën para lidhjes së kontratës për shitblerje e cila kontratë është jo zyrtare dhe nuk ka asnjë fuqi juridike. Gjithashtu në ankesë KESCO nuk është pajtuar që për faturat 03/2011 dhe 04/2011 të shlyhen të gjithë kilovatët por që janë pajtuar se mund të bëjmë shpërndarjen e këtyre kWh për një periudhë më të gjatë.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Departamenti i faturimit në KEDS me datë 04.11.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën tetor 2013 me shpenzim prej **7,796 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **581.13€**. Me datë 07.11.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës tetor 2013 për shkak të faturimit të kWh të grumbulluar.

Me datë 13.11.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 12233875 ku TL=005459 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=009820 kWh (tarifa e ulët).

Pas ankesës së konsumatorit me datë 15.11.2013 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë



elektrike si dhe listës së leximit për periudhën tetor 2013 duke bërë korrigjimin e faturave për periudhën 11/2012 deri në periudhën 10/2013 në vlerë **-214.61€**.

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-së, konsumatori me datë 19.12.2013 i është drejtuar DMK/ZRRE me ankesë me të cilën ka apeluar përgjigjen e KESCO-së dhe ka kërkuar që ti shlyhet borxhi i ngarkuar sipas tij në mënyrë paushallë. DMK/ZRRE pas shqyrtimit e ankesës së konsumatorit me datë 31.03.2016 ka marr vendim me të cilën ka aprovuar ankesën e konsumatorit duke e detyruar KESCO që të korrigjon faturat nr. 04080DPR 90036958 të datës 10.05.2008 dhe nr.05080DPR 90036958 të datës 10.06.2008 në vlerë **-31.78€**, dhe të anulon faturat nr.03110DPR 90036958 të datës 06.04.2011 dhe nr.04110DPR 90036958 të datës 06.05.2011 në vlerë totale **62.16€**.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 ka analizuar ankesën e parashtruar nga KESCO si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në rregulla dhe ligje.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë me të drejt ka vërtetuar gjendjen faktike ku ka konstatuar se konsumatori për periudhën kontestuese që i përket muajit 03 dhe 04/2011 nuk ka lexim dhe faturim të saktë në pikën matëse të konsumatorit pasi që i njëjti për këta dy muaj faturohet me paushall kur nga rrjedha e energjisë elektrike dihet se përveç këtyre muajve kontestues në këtë pikë matëse nuk ka pasur shpenzim të energjisë elektrike dhe faturimi ka qenë zero. Gjithashtu Bordi ka arsyetuar faktin se DMK me të drejtë ka bërë korrigjimin e vlerës financiare prej -31.78€ pasi që ka konsiderua se marr për bazë gjendjen e shpenzimeve të evidentuara nga konsumatori me datë 12.06.2012, si dhe faturimin pa matje dhe mos përputhjen e gjendjes së faturuar, për faturat 03110DPR 90036958 të datës 06.04.2011 dhe 04110DPR 90036958 të datës 06.05.2011, ka vlerësuar si të drejt të bëhet korrigjimi i faturave për periudhën 04/2008 - 05/2008.

Sa i përket pikës tjetër se kontrata e lidhur mes palëve është jo zyrtare dhe nuk prodhon efekt juridik dhe se faturimi është bërë vetëm njëherë, Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe këtë pikë dhe ka konstatuar se DMK/ZRRE ka bërë vlerësim të drejt në bazë të asaj se çka është faturuar në pikën matëse dhe se nuk ka qenë shumë relevante se cili konsumator ka qenë në periudhën e faturimit të pa bazë kur dihet që mandati i DMK/ZRRE është që në çdo rast kur vëren parregullsi e që dëmtojnë konsumatorin duhet të reagoj ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjithashtu pika tjetër e kundërshtimit se KESCO mund të bëjë korrigjimin për faturat e anuluar 03 dhe 04/2011 me një afat më të gjatë por që nuk pajtohet me anulimin e tërësishëm. Bordi pas shqyrtimit edhe kësaj pike ka konstatuar se KESCO e ka ngarkuar pa asnjë bazë konsumatorin për këta muaj kontestues pasi që nga rrjedha e energjisë elektrike për këtë periudhë kohore kjo pikë matëse është faturuar me zero shpenzim dhe poashtu parashtruesi KESCO nuk ka mund të vërtetoi se nga cila bazë e ngarkon konsumatorin kur dihet se në këto periudha nuk ka pas fare shpenzim të energjisë nga ana e konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se KESCO- sh.a. në ankesën e saj nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Krenar Bujupi, anëtar

---

Arsim Janova, anëtar

---

Qemajl Mustafa, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së: Departamenti për Konsumator dhe Operime,
- Konsumatorit R. M. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.